
METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR



Rruga "Naim Frashëri", Nr.37

Tiranë, Shqipëri, 1000

Phone: 04256440

Web: <https://www.ascap.edu.al>

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
Drejtoria e Performancës

Tiranë, Nëntor 2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 460/2 Prot.

Tiranë, më 16.3. 2022

URDHËR

Nr. 130, datë 16.3. 2022

PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS
SË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR DHE MANUALIT TË SAJ

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 11, të nenit 6 dhe të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj" dhe vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar dhe Manualit të saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Evis KUSHI



**METODOLOGJIA
E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË SISTEMIT
ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
Drejtoria e Performancës**

Tiranë, Nëntor 2021

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE

KAPITULLI I

QËLLIMI DHE FUNKSIONI I METODOLOGJISË

1. QËLLIMI I METODOLOGJISË

2. FUNKSIONI I METODOLOGJISË

KAPITULLI II

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

1. PLANIFIKIMI I VLERËSIMIT

- 1.1. Objekti i planifikimit
- 1.2. Mënyra e planifikimit
- 1.3. Koha e planifikimit
- 1.4. Planifikimi selektiv
- 1.5. Planifikimi i aspekteve të vlerësimit

2. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

- 2.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë
- 2.2. Intervistimi
- 2.3. Të dhëna zyrtare online
- 2.4. Të dhëna me kërkesë zyrtare
- 2.5. Raportet zyrtare
- 2.6. Të dhëna nga raportet ndërkombëtare
- 2.7. Të dhënat nga testimet ndërkombëtare
- 2.8. Të dhënat nga programet ndërkombëtare

3. KRITERET E VLERËSIMIT

- 3.1. Kriteri ligjor
- 3.2. Kriteri profesional
- 3.3. Kriteri financiar
- 3.4. Menaxhimi

4. NIVELET E VLERËSIMIT (Niveli 1-5)

5. VLERËSIMI I PERFORMANCËS

- 5.1. Kronologjia e vlerësimit të performancës
- 5.2. Skema e vlerësimit të masës/veprimtarisë
- 5.3. Monitorimi/vlerësimi i masave/produkteve/objektivave

6. TEKNIKA E VLERËSIMIT

- 6.1. Teknika e vlerësimit të masës/veprimtarisë
- 6.2. Teknika e vlerësimit të produktit
- 6.3. Teknika e vlerësimit të objektivit
- 6.4. Teknika e vlerësimit të qëllimit të politikës
- 6.5. Teknika e vlerësimit të performancës së sistemit

7. RAPORTI I VLERËSIMIT

- 7.1. Raporti i ndërmjetëm
- 7.2. Raporti vjetor
- 7.3. Raporti 5-Vjeçar

8. RAPORTIMI I INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

9. ANALIZA E REZULTATEVE

- 9.1. Analiza e nivelit të realizimit të masës/veprimtarisë
- 9.2. Analiza e nivelit të realizimit të produktit
- 9.3. Analiza e nivelit të realizimit të objektivit

10. PRODUKTET E VLERËSIMIT

KAPITULLI III

1. ANEKS: PASAPORTA E TREGUESVE TË STRATEGJISË 2021-2026

2. REFERENCAT

HYRJE

Metodologjia e Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar, është një dokument i ri, i pari i këtij lloji, që i bashkëngjitet Manualit të Vlerësimit të Performancës, i cili vjen si detyrim për të kompletuar dokumentacionin orientues, për një vlerësim të saktë, të besueshëm dhe të dobishëm të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky dokument, bën të mundur që vlerësimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar të realizohet sipas një metodologjie, në të cilën përcaktohen mënyra e planifikimit dhe e mbledhjes së të dhënave, si dhe teknika e vlerësimit të performancës së sistemit, bazuar në kriteret e vendosura për vlerësim. Kriteret janë rregullatorë ligjorë, administrativë dhe financiarë, ndërsa teknika e vlerësimit është një proces zinxhir, që fillon nga poshtë-lart me vlerësimin e rezultateve të masave/veprimtarive, nëpërmjet treguesve të matjes, vazhdon me vlerësimin e realizimit të produkteve e objektivave dhe përfundon me vlerësimin e realizimit të qëllimit të politikave.

Procesi i vlerësimit të performancës së sistemit, bazohet në krahasimin:

“Rezultat i pritshëm - Realizim”, sipas masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, (shkurt SKA) [1].

SHKURTIMET

ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DP	Drejtoria e Performancës në ASCAP
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISCED	Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit
KVP	Korniza e Vlerësimit të Performancës
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MASR	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
MVP	Manuali i Vlerësimit të Performancës
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
PV	Plani i Veprimit
SAPU	Sistemi Arsimit Parauniversitar
SKA	Strategjia Kombëtare e Arsimit
SMIP	Sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën
VANAF	Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin fillor
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

KAPITULLI I

QËLLIMI DHE FUNKSIONI I METODOLOGJISË

1. QËLLIMI I METODOLOGJISË

Qëllimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës është të tregojë mënyrën se “SI” realizohet vlerësimi i performancës së SAPU-së, në zbatim të procedurave të përcaktuara në Manualin e Vlerësimit të Performancës. Metodologjia është hartuar në mbështetje të kontekstit, analizës së gjendjes së sistemit dhe qëllimit të politikave të përshkruara në Manualin e Vlerësimit të Performancës.

2. FUNKSIONI I METODOLOGJISË

Funksioni kryesor i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës, është të tregojë në mënyrë të detajuar se si veprohet, për vlerësimin e arritjeve të synuara në objektivat e SKA-së, duke treguar të gjitha hapat që ndiqen.

Hapi i parë, është planifikimi i vlerësimit, ku përcaktohen: struktura planifikuese, koha dhe hapësira, bazuar në kriteret përkatëse.

Hapi i dytë, është grumbullimi i të dhënave, ku përshkruhen llojet, mënyra e grumbullimit dhe burimet e të dhënave.

Hapi i tretë, është zbatimi i kriterëve të vendosura në formatin: Korniza e Vlerësimit të Performancës (KVP), për vlerësimin e nivelit të realizimit të produkteve.

Hapi i katërt, është përcaktimi i kronologjisë dhe teknikës/skemës së vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar.

Për kryerjen e këtij funksioni, metodologjia parashikon hartimin e formateve Tip të vlerësimit, si dhe pyetësorëve në ndihmë të realizimit të këtij procesi.

Mbi bazën e këtij vlerësimi, Ministria përgjegjëse për arsimin, harton politika të reja dhe programe afatgjatë, për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në fushën e arsimit parauniversitar, në kontekstin e zhvillimit të shoqërisë.

Ky dokument u vjen në ndihmë specialistëve në fushën e arsimit, duke i orientuar ata në mënyrë që vlerësimi i performancës së SAPU-së, të bëhet nëpërmjet një metodologjie, bazuar në parimet kryesore të vlerësimit të performancës: “Saktësi - Drejtësi - Besueshmëri - Dobi”.

KAPITULLI II

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

1. PLANIFIKIMI I VLERËSIMIT

Planifikimi është një proces që paraqet një aktivitet të lartë profesional. Sukses i punës mbështetet në një planifikim sa më të mirë, sipas parimit: “Nëse dështon në planifikim, do të thotë që ke planifikuar dështimin”.

1.1. Objekti i planifikimit

Objekti i planifikimit është përcaktimi i hapave që ndiqen për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor dhe përcaktimi i strukturave, detyrave dhe afateve kohore, për realizimin e hapave të vlerësimin.

1.2. Mënyra e planifikimit

Të planifikosh do të thotë të paramendosh, të projektosh dhe të zbërthesh qartë çështjet që do të vlerësohesh. Planifikimi i vlerësimin kryhet për të siguruar përgatitjet, bazuar në burimet njerëzore dhe financiare, apo kushte të tjera të nevojshme, për të realizuar vlerësimin. Që vlerësimi të jetë i dobishëm, ai duhet planifikuar dhe realizuar në kohë, në mënyrë që rezultatet e tij të përdoren për përmirësimin e politikave.

1.3. Koha e planifikimit

Përgatitjet për vlerësimin duhet të fillojnë të paktën tre muaj para nisjes së vlerësimin. Planifikimi i vlerësimin të performancës bëhet në përfundim të çdo viti shkollor, bashkë me përcaktimin e strukturave vlerësuese dhe detyrave të secilit vlerësues. Planifikimi i fundit bëhet për vlerësimin e një periudhe 5-vjeçare në përputhje me afatet e Planit të Veprimit të SKA-së.

1.4. Planifikimi selektiv

Në disa raste, mund të ndodhë që, për shkak të ndryshimit të kontekstit, të ndërmerren masa të paparashikuara të cilat bëhen objekt i vlerësimin. Mund të vlerësohen gjithashtu edhe ndërhyrjet në buxhetet e mëdha, apo çështjet e rëndësishme, që lidhen me qëllimin e politikave. Në këto raste, lind nevoja e një planifikimi selektiv për një masë apo ndërhyrje të caktuar në sistem.

1.5. Planifikimi i aspekteve/pyetjeve kryesore të vlerësimin

Për të orientuar vlerësimin, është e nevojshme që të përcaktohen aspektet dhe pyetjet e vlerësimin. Aspektet e vlerësimin lidhen me efikasitetin e zbatimit të objektivave të SKA-së dhe përgjegjësinë e strukturave menaxhuese në zbatimin e tyre. Pyetjet e vlerësimin hartohen, në mënyrë të tillë, që t’u japin përgjigje vlerësuesit në raportin e tyre të vlerësimin. Pyetjet e vlerësimin duhet të jenë specifike për secilën masë/veprimtari, duke marrë parasysh mangësitë në zbatim, gjetjet e raporteve të monitorimit dhe nevojat e vendimmarrësve.

2. METODAT E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (sot ASCAP) [2], ka për mision garantimin e performancës së sistemit të arsimit parauniversitar dhe cilësinë e arsimit parauniversitar publik e privat, në përputhje me kurrikulën, bazuar në zhvillimin e kompetencave.

Metodat e mbledhjes së të dhënave që përdoren për Vlerësimin e Performancës janë:

2.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë

Monitorimi i drejtpërdrejtë, përdoret në rastet e nivelit të ulët të besimit në struktura të posaçme të sistemit, ose kur nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme.

2.2. Intervistimi

Intervistimi përdoret për të marrë mendimin e specialistëve të pavarur, drejtuesve të institucioneve, si dhe grupeve të tjera të interesit.

2.3. Të dhënat zyrtare online

Të dhënat zyrtare online përdoren në rastet e të dhënave të konfirmuara zyrtarisht nga institucionet kombëtare, si INSTAT [3], ministritë etj.

2.4. Të dhënat me kërkesë zyrtare

Të dhënat me kërkesë zyrtare janë të dhënat me postë, ose me e-mail, kur nuk është e mundur marrja e të dhënave online.

2.5. Raportet zyrtare

Raportet zyrtare, janë të dhënat e marra nga raportet, të certifikuara zyrtarisht.

2.6. Të dhëna nga raportet ndërkombëtare

Të dhëna nga raportet ndërkombëtare janë të dhënat që merren nga raportet e institucioneve që bëjnë vlerësime ndërkombëtare, si OECD [4], UNESCO[5], etj.

2.7. Të dhënat nga testimet ndërkombëtare

Të dhënat nga testimet ndërkombëtare janë të dhënat e grumbulluara nga testimet ndërkombëtare, në të cilat merr pjesë Shqipëria, si: PISA [6], olimpiadat ndërkombëtare etj.

2.8. Të dhënat nga programet ndërkombëtare

Të dhënat nga programet ndërkombëtare janë ato të dhëna që merren nga vlerësimet e programeve ndërkombëtare.

3. KRITERET E VLERËSIMIT

Kriteret për Vlerësimin e Performancës, janë të përcaktuara në Manualin e Vlerësimit të Performancës. Për të vlerësuar nivelin e plotësimit të kritereve vepohet, si më poshtë:

3.1. Kriteri ligjor

Vlerësohet niveli i plotësimit të kuadrit ligjor, në funksion të arritjes së objektivave strategjikë.

3.2. Kriteri profesional

Vlerësohet kapaciteti i burimeve njerëzore dhe strukturave të nevojshme, në funksion të arritjes së objektivave strategjike.

3.3. Kriteri financiar

Vlerësohet niveli i sigurimit dhe përdorimit të burimeve financiare të parashikuara për arritjen e objektivave strategjike.

3.4. Menaxhimi

Vlerësohet ecuria e realizimit të masave/produkteve/objektivave, në funksion të arritjes së qëllimit të politikave të SKA-së.

KORNIZA E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS (përcaktuar në Manualin e Vlerësimit të Performancës)

VLERËSIMI	KRITERET E VLERËSIMIT	PËRQINDJA	NIVELI
Nuk ka progres	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mungon kuadri i plotë ligjor, mungojnë aktet nënligjore, si: vendimet, udhëzimet, rregullat për realizimin e objektivave/qëllimit të politikave të SKA-së. ▪ Ka mungesa në plotësimin e strukturave. ▪ Mungojnë burimet financiare të nevojshme për zbatimin e akteve nënligjore dhe ndërtimin e strukturave institucionale. ▪ Mungojnë hapat konkretë në drejtim të menaxhimit. 	0-19 %	1
Ka pak progres	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ekzistojnë ligjet kryesore, vendimet, udhëzimet dhe planet për realizimin e objektivave/qëllimit të politikave të SKA-së, por ka mungesa akoma në kuadrin ligjor. ▪ Struktura institucionale është plotësuar mjaftueshëm, por ka akoma mungesa në burimet njerëzore. ▪ Mungojnë burimet financiare për të mbështetur zbatimin e objektivave. ▪ Ka hapa të ngadalshëm për realizimin e planeve të hartuara, bazuar në praktikat më të mira. 	20-39 %	2
Në progres e sipër	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kuadri ligjor është miratuar në funksion të realizimit të objektivave dhe legjislacioni është në zbatim e sipër në dy vitet e fundit. ▪ Struktura institucionale është e plotësuar. ▪ Ka mbështetje të pjesshme financiare në zbatim të pjesëve të veçanta të kuadrit ligjor dhe politikave. ▪ Ekzistojnë praktika të mira menaxheriale për zhvillimin e veprimtarive, por ka vonesa në zbatimin e tyre. 	40-59 %	3
Ka shumë progres	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Janë miratuar të gjitha ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret për realizimin e qëllimit të politikave të SKA-së. ▪ Struktura institucionale është e plotësuar dhe kapacitetet njerëzore funksionojnë mirë. ▪ Ka mungesa në mbështetjen financiare për realizimin e plotë dhe në kohë të Planit të Veprimit të SKA-së. ▪ Ecuria e realizimit masave/veprimtarive është e dukshme në katër vitet e fundit, bazuar në praktika të zhvilluara në zbatim të kuadrit ligjor. 	60-79 %	4
Realizuar	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Janë miratuar të gjitha ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret për realizimin e qëllimit të politikave të SKA-së. ▪ Struktura institucionale është e plotësuar dhe kapacitetet njerëzore funksionojnë shumë mirë. ▪ Financimi është në përputhje të plotë me kontekstin dhe zhvillimet në zbatim të qëllimit të politikave. ▪ Është krijuar një model i qëndrueshëm i menaxhimit institucional për zbatimin e kuadrit ligjor në katër vitet e fundit dhe vonesat janë shumë të rralla apo të përkohshme. 	80-100 %	5

4. NIVELET E VLERËSIMIT

Bazuar në kriteret e vlerësimit të performancës, të përcaktuara në Manualin e Vlerësimit, përshkruhen nivelet e vlerësimit, duke shpjeguar rastet e përdorimit të secilit nivel.

- Niveli 1
- Niveli 2
- Niveli 3
- Niveli 4
- Niveli 5

Niveli 1

Ky nivel nënkupton faktin se, në realizimin e masës/produktit/objektivit, nuk ka pasur progres. Mungesa e progresit, mund të ketë ardhur për arsye që lidhen me mungesën e plotë të legjislacionit, pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore (ose mosfunksionimin e administratës), mungesën e plotë të burimeve financiare, apo ndryshimin tërësor të politikave në mënyrë të paparashikuar.

Vlerësimi në përqindje, është 0-19%.

Rezultati në këtë vlerësim është **“tërësisht i kritikueshëm”**.

Rekomandohen masa të menjëhershme, për sigurimin e kushteve për realizimin e objektivit të parashikuar.

Niveli 2

Ky nivel nënkupton faktin se, në realizimin e masës/produktit/objektivit, ka pasur pak progres. Progresi i ulët, mund të ketë ardhur për arsye që lidhen me vonesa në miratimin e kuadrit rregullator të parashikuar, mosfunksionimin si duhet të administratës, pamjaftueshmërinë e burimeve, apo ndryshimin e politikave në mënyrë të paparashikuar.

Vlerësimi në përqindje është 20-39%.

Rezultati në këtë vlerësim është **“i kritikueshëm”**.

Rekomandohen masa të shpejta, për plotësimin e kushteve ligjore dhe administrative për realizimin e objektivit të parashikuar.

Niveli 3

Ky nivel nënkupton faktin se procesi i realizimit të masës/produktit/objektivit, është në progres e sipër dhe se objektivi rezulton i realizuar pjesërisht. Kjo mund të ketë ardhur për arsye vonesash në miratimin e pjesëve të veçanta të kuadrit ligjor dhe në zhvillimin e veprimtarive, në zbatim të praktikave të mira.

Vlerësimi në përqindje është 40-59%.

Rezultati në këtë vlerësim është **“i pranueshëm/i kënaqshëm”**.

Rekomandohet marrja e masave për plotësimin e kuadrit ligjor, vënien në zbatim të plotë të strukturave dhe mbështetje financiare në kohë, për realizimin e objektivit të parashikuar.

Niveli 4

Ky nivel nënkupton faktin se, në realizimin e masës/produktit/objektivit, ka pasur progres të dukshëm në miratimin e kuadrit ligjor, ndërtimin e kapaciteteve të mjaftueshme institucionale dhe zbatimin e praktikave më të mira, por mbështetja financiare nuk ka qenë e plotë, gjë që ka ndikuar në mosrealizimin tërësor të objektivit.

Vlerësimi në përqindje është **60-79%**.

Rezultati në këtë vlerësim është “i mirë”.

Rekomandohet sigurimi i mbështetjes së plotë financiare, për realizimin e objektivit të parashikuar.

Niveli 5

Ky nivel nënkupton realizimin e plotë, ose pothuajse të plotë, të masës/produktit/objektivit, në drejtim të miratimit dhe zbatimit të legjislacionit, të ndërtimit të kapaciteteve institucionale, financimit dhe zbatimit të praktikave më të mira.

Vlerësimi në përqindje është **80-100%**.

Rezultati në këtë vlerësim është **“shumë i mirë/ekselent”**.

5. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SISTEMIT

5.1. Kronologjia e vlerësimit të performancës

Në SKA, është përcaktuar hierarkia e komponentëve, si më poshtë:

- Vizioni
- Qëllimi i politikave
- Objektivat
- Produktet
- Masat

Vlerësimi i Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar realizohet në mënyrë të përshkallëzuar, nga poshtë lart, duke filluar me nivelin e realizimit të treguesve, që përcaktojnë nivelin e realizimit të masave/veprimtarive dhe duke përfunduar me vlerësimin e qëllimit të politikave.

Për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor, ndiqet kronologjia e mëposhtme:

5.1.1. Masa/veprimtaria

5.1.2. Produkti

5.1.3. Objektivi

5.1.4. Qëllimi i politikës

5.1.5. Performanca e sistemit

5.2. Skema e vlerësimit të masës/veprimtarisë

5.2.1. Përshkrimi i masës/veprimtarisë

- Institucioni përgjegjës
- Afati i realizimit

5.2.2. Masa/veprimtaria

- Dizajni
- Grafikët

5.2.3. Treguesit e matjes

5.2.4. Rezultati i realizimit të treguesve në %

5.2.5. Vlerësimi i realizimit të masës/veprimtarisë 1-5

5.2.6. Arritjet dhe defektet

5.2.7. Konkluzione

5.2.8. Rekomandime

5.3. Përshkrimi i mënyrës së vlerësimit

- i. Niveli i realizimit të treguesve për çdo masë/veprimtari, shprehet në përqindje dhe përkthehet në indeks zbatimi 1-5.
- ii. Nëpërmjet mesatares së indekseve të zbatimit të treguesve, vlerësohet niveli i realizimit të masës/veprimtarisë.
- iii. Nëpërmjet mesatares së indekseve të zbatimit, për nivelin e realizimit të masës/veprimtarisë, vlerësohet niveli i realizimit të produktit.
- iv. Nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të produkteve, shprehur me indeks zbatimi, vlerësohet niveli i realizimit të objektivit.
- v. Nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të objektivave, vlerësohet niveli i realizimit të Qëllimit të Politikës.

vi. Në përfundim, nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të Qëllimit të Politikave, bëhet Vlerësimi i Performancës së Sistemit Arsimor.

5.4. Formati i monitorimit/vlerësimit të masave/produkteve/objektivave

Vlerësimi bëhet sipas Pasaportës së Treguesve të SKA-së [7],

MONITORIMI/VLERËSIMI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË SKA-SË							
Nr.	Objektivi specifik/ produkti/ masa	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Rezultati në %	Përshkrimi i arritjeve
		Institucioni përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit		
A1							
A1.1							
A1.1.1							
T. 1-N							
A1.1.N							
T. 1-N							
A1.N							
A1.N.1							
T. 1-N							
A1.N.N							
T. 1-N							
A.N							
A.N.1							
A.N.1.1							
T. 1-N							
A.N.1.N							
T. 1-N							
A.N.N							
A.N.N.1							
T. 1-N							
A.N.N.N							
T. 1-N							

6. TEKNIKA E VLERËSIMIT

6.1. Teknika e vlerësimit të realizimit të masës/veprimtarisë

6.1.1. Matja e treguesve kombëtarë të realizimit të masës/veprimtarisë

6.1.2. Përqindja e realizimit të treguesve

6.1.3. Niveli i indeksuar 1-5, i realizimit të treguesve

6.1.4. Niveli i indeksuar 1-5, i realizimit të masës/veprimtarisë

Qëllimi	X - N
Objektivi	X.1 - X.N
Produkti	X.1.1. - X.N.N
Masa	X.1.1.1. - X.N.N.N

Formati i vlerësimit të realizimit të masës/veprimtarisë

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS/VEPRIMTARISË - Indeksi 1-5				
Nr.	Masa/Veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1-5
X.N.N.N.	Përshkrimi i masës/veprimtarisë	T1	%	Indeksi 1-5
		TN	%	
	Vlerësimi i realizimit të masës/veprimtarisë X.N.N.N.		% mesatare	

Shembull

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS/VEPRIMTARISË - Indeksi 1-5				
Nr.	Masa/veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi	Vlerësimi
X.N.N.N.	Përshkrimi i masës/veprimtarisë	T1	36%	2.10
		TN	48%	
	Vlerësimi i realizimit të masës/veprimtarisë X.N.N.N.		42%	

6.2. Teknika e vlerësimit të realizimit të produktit

Për bazë merret mesatarja e indekseve të zbatimit të masave/veprimtarive. Nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të masave/veprimtarive, shprehur me indeks zbatimi 1-5, vlerësohet niveli i realizimit të produktit.

Formati i vlerësimit të realizimit të produktit

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT (1-5)			
Nr.	Produkti	Masa/veprimtaria	Vlerësimi
X.N.N.	Përshkrimi i produktit	X.N.N.1	Indeksi
		X.N.N.N	Indeksi
	Vlerësimi i realizimit të produktit X.N.N.		

Shembull

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT (1-5)			
Nr.	Produkti	Masa/veprimtaria	Vlerësimi
X.N.N.	Përshkrimi i produktit	Psh 64 %	3.20
		42 %	2.10
	Vlerësimi i realizimit të produktit X.N.N.		

Formati i plotë i vlerësimit të realizimit të produktit

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT X.N.N.							
Nr.	Produkti	Masa/ veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1-5		
X.N.N	Përshkrimi i produktit	X.N.N.1	T1		Indeksi		
			TN				
		Vlerësimi i masës X.N.N.1		%			
		X.N.N.N	T1			Indeksi	
			TN				
		Vlerësimi i masës X.N.N.N		%			
		Vlerësimi i realizimit të produktit X.N.N.					Indeksi mesatar

Shembull: Formati i plotë i vlerësimit të realizimit të produktit

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT X.N.N.							
Nr.	Produkti	Masa/ veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1-5		
X.N.N	Përshkrimi i produktit	X.N.N.1	T1	53%	3.20		
			TN	75%			
		Vlerësimi i masës X.N.N.1		64 %			
		X.N.N.N	T1	36%		2.10	
			TN	48%			
		Vlerësimi i masës X.N.N.N		42 %			
		Vlerësimi i realizimit të produktit X.N.N.					2.65

6.3. Teknika e vlerësimit të realizimit të objektivit

Nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të produkteve, shprehur me indeks zbatimi 1-5, vlerësohet niveli i realizimit të objektivit.

Formati i vlerësimit të realizimit të objektivit

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT (1-5)			
Nr.	Objekti	Produkti	Vlerësimi
X.N.	Përshkrimi i objektivit	X.N.1.	Indeksi
		X.N.N.	Indeksi
	Vlerësimi i realizimit të objektivit X.N.		Indeksi mesatar

Shembull

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT (1-5)			
Nr.	Objekti	Produkti	Vlerësimi
X.N.	Përshkrimi i objektivit	X.N.1.	Psh. 3.15
		X.N.N.	2.65
	Vlerësimi i realizimit të objektivit X.N.		2.90

Formati i plotë i vlerësimit të realizimit të objektivit

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT (1-5)						
Objektivi	Produkti	Masa/veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1-5	
X.N.	X.N.1.	X.N.N.1	T1		Indeksi	
			TN			
		Vlerësimi i masës X.N.N.1		%		
		X.N.N.N	T1			Indeksi
	TN					
	Vlerësimi i masës X.N.N.N		%			
	Vlerësimi i produktit X.N.1.				Indeksi mesatar M1-MN	
	X.N.N	Vlerësimi i produktit X.N.N				Indeksi mesatar M1-MN
Vlerësimi i realizimit të objektivit X.N					Indeksi mesatar i ponderuar P1-PN	

Shembull: Format i plotë i vlerësimit të realizimit të objektivit

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT (1-5)						
Objektivi	Produkti	Masa/veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1-5	
X.N.	X.N.1.	X.N.N.1	T1		3.20	
			TN			
		Vlerësimi i masës X.N.N.1		64 %		
		X.N.N.N	T1			2.10
	TN					
	Vlerësimi i masës X.N.N.N		42 %			
	Vlerësimi i produktit X.N.1.				Psh. 3.15	
	X.N.N	Vlerësimi i produktit X.N.N				2.65
Vlerësimi i realizimit të objektivit X.N					2.90	

6.4. Teknika e vlerësimit të realizimit të qëllimit të politikës

Nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të objektivave, shprehur me indeks zbatimi 1-5, vlerësohet niveli i realizimit të qëllimit të politikës.

Formati i vlerësimit të realizimit të qëllimit të politikës

VLERËSIMI I I REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË POLITIKËS (1-5)			
Nr.	Qëllimit i politikës	Objektivi	Vlerësimi
X	Përshkrimi i qëllimit të politikës	X.1.	Indeksi
		X.N.	Indeksi
	Vlerësimi i realizimit të qëllimit të politikës X		Indeksi mesatar

Shembull

VLERËSIMI I I REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË POLITIKËS (1-5)			
Nr.	Qëllimit i politikës	Objektivi	Vlerësimi
X	Përshkrimi i qëllimit të politikës	X.1.	Psh.3.30
		X.N.	2.90
	Vlerësimi i realizimit të qëllimit të politikës X		3.10

Formati i plotë i vlerësimit të realizimit të Qëllimit të Politikës

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË POLITIKËS (1-5)							
Qëllimi	Objektivi	Produkti	Masa/ veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1- 5	
X	X.1.	X.N.1.	X.N.N.1	T1		Indeksi	
				TN			
			Vlerësimi i masës X.N.N.1		%		
		X.N.N.N.	T1		Indeksi		
			TN				
		Vlerësimi i masës X.N.N.N.		%			
	Vlerësimi i produktit X.N.1.					Indeksi mesatar M1-MN	
		X.N.N	Vlerësimi i produktit X.N.N				Indeksi mesatar M1-MN
	Vlerësimi i objektivit X.1					Indeksi mesatar M1-MN	
		X.N.	Vlerësimi i objektivit X.N				Indeksi mesatar M1-MN
Vlerësimi i qëllimit të politikës X					Indeksi mesatar P1-PN		

Shembull: Format i plotë i vlerësimit të realizimit të qëllimit të politikës

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË POLITIKËS (1-5)							
Qëllimi	Objektivi	Produkti	Masa/ veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1- 5	
X	X.1.	X.N.1.	X.N.N.1	T1		3.20	
				TN			
			Vlerësimi i masës X.N.N.1		64 %		
		X.N.N.N.	T1		2.10		
			TN				
		Vlerësimi i masës X.N.N.N.		42 %			
	Vlerësimi i produktit X.N.1.					Psh 3.15	
		X.N.N	Vlerësimi i produktit X.N.N				2.65
	Vlerësimi i objektivit X.1					Psh 3.70	
		X.N.	Vlerësimi i objektivit X.N				2.90
Vlerësimi i qëllimit të politikës X					3.30		

6.5. Teknika e vlerësimit të performancës së sistemit

Në përfundim, nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të qëllimit të politikave, vlerësohet performanca e sistemit arsimor parauniversitar.

Formati i vlerësimit të performancës së sistemit

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU- SË		
PERFORMANCA E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR	Qëllimi i politikës	Vlerësimi 1-5
	Përshkrimi i qëllimit të politikës 1	Indeksi mesatar
	Përshkrimi i qëllimit të politikës X	Indeksi mesatar
	Vlerësimi i performancës së SAPU-së	Indeksi mesatar P1-PN

Shembull: Formati i vlerësimit të performancës së sistemit

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU- SË		
PERFORMANCA E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR	Qëllimi i politikës	Vlerësimi 1-5
	Përshkrimi i qëllimit të politikës 1	Psh 2.70
	Përshkrimi i qëllimit të politikës X	3.30
	Vlerësimi i performancës së SAPU-së	3.00

Formati i plotë i vlerësimit të performancës së sistemit

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU- SË (1-5)								
Qëllimi	Objektivi	Produkti	Masa/veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1-5		
1	X.1.	X.N.1.	X.N.N.1	T1				
				TN				
			Vlerësimi i masës X.N.N.1					
			X.N.N.N.	T1				
				TN				
			Vlerësimi i masës X.N.N.N.					
	Vlerësimi i produktit X.N.1.							
	X.N.N	Vlerësimi i produktit X.N.N						
	Vlerësimi i objektivit X.1							
	X.N.	Vlerësimi i objektivit X.N						
Vlerësimi i qëllimit të politikës 1								
X	Vlerësimi i qëllimit të politikës X							
Vlerësimi i performancës së SAPU- SË								

Shembull: Format i plotë i vlerësimit të performancës së sistemit

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU- SË (1-5)							
Qëllimi	Objektivi	Produkti	Masa/veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1-5	
1	X.1.	X.N.1.	X.N.N.1	T1		2.10	
				TN			
			Vlerësimi i masës X.N.N.1			42%	
			X.N.N.N.	T1			
				TN			
			Vlerësimi i masës X.N.N.N.			64%	
	Vlerësimi i produktit X.N.1.					Psh 3.15	
	X.N.N	Vlerësimi i produktit X.N.N				2.65	
	Vlerësimi i objektivit X.1					Psh 3.70	
	X.N.	Vlerësimi i objektivit X.N				2.90	
Vlerësimi i qëllimit të politikës 1						Psh 2.70	
X	Vlerësimi i qëllimit të politikës X					3.30	
Vlerësimi i performancës së SAPU- SË						3.00	

7. RAPORTI I VLERËSIMIT

7.1. Raporti i ndërmjetëm

Raporti i Ndërmjetëm është një dokument pune, që jep një pasqyrë të nivelit të arritjeve disa mujore, në zbatim të Planit të Veprimit (PV) të SKA-së dhe jep rekomandime, lidhur me hapat që duhet të ndërmerren për realizimin e objektivave. Ky Raport, përdoret për rishikimin e progresit të bërë brenda një periudhe disa mujore.

Shembull: Raporti i ndërmjetëm (Raporti 4 - mujor)

Një raport 4-mujor përgatitet sipas mënyrës së mëposhtme:

- a. Deri me datën 25 të çdo 4-mujori, p.sh. 25 prill, 25 korrik, 25 tetor dhe 24 dhjetor, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (sot ASCAP) kërkon të dhëna nga institucionet në varësi të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, lidhur me veprimtaritë që zbatohen gjatë periudhës përkatëse të raportimit, në zbatim të Planit të Veprimit të SKA-së.
- b. Deri me datën 10 të muajit të raportimit p.sh. 10 maj, 10 gusht, 10 nëntor dhe 10 shkurt, strukturat përkatëse të Ministrisë dhe institucionet e varësisë, që janë përgjegjëse për veprimtaritë, siç është parashikuar në PV, duhet të japin të dhëna pranë ASCAP-it sipas një formati të përcaktuar në metodologji.
- c. ASCAP-i, nëpërmjet Drejtorisë së Performancës (DP), analizon informacionin e marrë nga strukturat/institucionet përkatëse, kryen vlerësimin dhe harton një projekt - raporti 4-mujor të progresit. ASCAP-i mund të kërkojë të dhëna shtesë nga strukturat përgjegjëse përkatëse, nëse informacioni i paraqitur nuk është i qartë, i mjaftueshëm, ose nëse është i pakënaqshëm.
- d. Deri me datën 20 të muajit të raportimit, ASCAP-i finalizon raportin e progresit 4-mujor dhe e dërgon në Ministri.

7.2. Format - Raporti i Ndërmjetëm

Objektivi	Produkti	Masa	Afati	Buxheti	Realizimi me përshkrim dhe në %	Hapat e mëtejshëm	Koha e pritshme e realizimit
1	2	3	4	5	6	7	8
Plotësohet nga ASCAP	ASCAP	ASCAP	ASCAP	ASCAP	Institucioni përgjegjës	Institucioni përgjegjës	Institucioni përgjegjës

Në kolonën 1, tregohet objektivi që do të arrihet nëpërmjet realizimit të produkteve. Kjo kolonë plotësohet nga ASCAP-i.

Në kolonën 2, tregohet produkti që do të arrihet nëpërmjet realizimit të masave. Kjo kolonë plotësohet nga ASCAP-i.

Në kolonën 3, tregohet masa/veprimtaria që do të merret, sipas Planit të Veprimit. Kjo kolonë plotësohet nga ASCAP-i.

Në kolonën 4, jepet afati i përcaktuar në Planin e Veprimit, për realizimin objektivit. Kjo kolonë plotësohet nga ASCAP-i.

Në kolonën 5, jepet buxheti i planifikuar për realizimin e objektivit/objektivave. Kjo kolonë plotësohet nga ASCAP-i.

Në kolonën 6, jepet përshkrimi i arritjeve dhe niveli në përqindje i realizimit të objektivave. Çdo strukturë përgjegjëse jep të dhëna, lidhur me realizimin e treguesve. Arritjet, kur është e mundur, duhet të mbështeten me të dhëna statistikore, krahasime, etj. Në qoftë se një akt ligjor/nënligjor është përgatitur gjatë realizimit të masave/veprimtarive, strukturat shpjegojnë se çfarë do të ndryshojë dhe cilat janë përfitimet kryesore nga miratimi i tij. Të dhënat e paraqitura në këtë kolonë duhet të justifikojnë statusin e realizimit të produktit. Kjo kolonë plotësohet nga institucioni përgjegjës, përcaktuar në Planin e Veprimit.

Në kolonën 7, jepen hapat që pritet të hidhen për realizimin e objektivave. Kjo kolonë plotësohet vetëm për ata tregues, statusi i të cilëve është “realizuar pjesërisht” ose “i përcaktuar”. Kjo kolonë plotësohet nga institucioni përgjegjës, përcaktuar në Planin e Veprimit.

Në kolonën 8, jepet pritshmëria kohore e realizimit të objektivit/produktit/masës. Institucioni përgjegjës duhet të tregojë afatin e ri të pritshëm të realizimit të treguesve, bazuar në hapat e mëtejshëm. Informacioni jepet, lidhur me nivelin e realizimit 4 - muhor dhe pritshmëritë kohore për realizimin e plotë. Kjo kolonë plotësohet vetëm për ata tregues, të cilët nuk janë përfunduar, ose nuk kanë filluar. Kjo kolonë plotësohet nga institucioni përgjegjës, përcaktuar në Planin e Veprimit.

7.3. Raporti Vjetor

Raportit Vjetor i Vlerësimit të Performancës së SAPU-së, është dokumenti më i rëndësishëm që prodhon institucioni i vlerësimit të cilësisë (sot ASCAP), lidhur me progresin e bërë në arsimin parauniversitar, gjatë një viti shkollor. Raporti paraqet në mënyrë analitike veprimtaritë e zhvilluara, duke evidentuar faktorët kryesorë që kanë ndikuar në arritjen apo mosarritjen e objektivave të strategjisë.

Analiza e rezultateve të objektivave/produkteve/masave, në kuadër të zbatimit të qëllimit të politikave të SKA-së, bëhet bazuar në të dhëna të sakta statistikore dhe, për të qenë sa më e qartë, ilustron me grafikë, tabela etj.

Raporti Vjetor i Vlerësimit të Performancës së SAPU-së, shërben si informacion për publikun, lidhur me nivelin e arsimit parauniversitar në Shqipëri dhe njëkohësisht si llogaridhënie e strukturave përgjegjëse në raport me realizimin/mosrealizimin e objektivave të strategjisë.

Raporti Vjetor përgatitet sipas procedurës së mëposhtme:

- a. Brenda datës 20 korrik, në përfundim të vitit shkollor, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (ASCAP-i) kërkon të dhëna nga institucionet në varësi të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, lidhur me realizimin e treguesve të Strategjisë.
- b. Deri me datën 20 shtator, institucionet përgjegjëse/kontribuese duhet të japin të dhëna te institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (ASCAP-i), në formatin e dhënë.
- c. Deri me datën 20 nëntor, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (ASCAP-i) analizon të dhënat e marra nga institucionet përgjegjëse/kontribuese dhe përgatit Projektin Raportin Vjetor të Vlerësimit të Performancës. Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (ASCAP-i) mund të kërkojë të dhëna shtesë nga këto institucione, në qoftë se të dhënat e paraqitura nuk janë të mjaftueshme. Në qoftë se është e nevojshme, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (ASCAP-i) mund të organizojë takime, seminare për të orientuar stafet e njësisë përgjegjëse,

lidhur me aftësitë e nevojshme për të përgatitur raportet/informacionet që lidhen me zbatimin e objektivave të Strategjisë.

- d. Deri me datën 20 dhjetor institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (ASCAP-i) duhet të paraqesë Raportin Vjetor të Vlerësimit të Performancës, pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Formati i Raportimit Vjetor është përcaktuar në Manualin e Vlerësimit.

7.4. Raporti 5-Vjeçar

Në përfundim të afatit të SKA-së, institucioni i sigurimit të cilësisë (ASCAP-i) do të hartojë Raportin e Vlerësimit për nivelin e realizimit të qëllimit të politikave. Ky vlerësim do të shërbejë si bazë për hartimin e Strategjisë së re, që nënkupton ndërtimin e politikave të reja, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së arsimit parauniversitar në Shqipëri. Raporti i Vlerësimit të Performancës së SAPU-së, do të marrë parasysh të gjitha vlerësimet e ndërmjetme dhe raportimet ndërkombëtare, lidhur me sistemin tonë arsimor.

Formati i Raportit 5-vjeçar, ruan të njëjtën kronologji me formatin e Raportit Vjetor.

Raporti i vlerësimit të nivelit të zbatimit Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (strategjia paraardhëse), do të jetë një dokument orientues, për të bërë analiza dhe krahasime [8].

8. RAPORTIMI I INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE/KONTRIBUESE

Me qëllim përgatitjen e një raporti gjithëpërfshirës, kontributet e raporteve të institucioneve përgjegjëse/kontribuese, do të përqendrohen në nivelin e realizimit të masave/veprimtarive.

Raportimi për realizimin e masës/veprimtarisë

Çdo strukturë përgjegjëse është e detyruar të japë të dhëna të mjaftueshme për nivelin e realizimit të masave/veprimtarive, bazuar në pasaportën e treguesve të SKA-së. Nëse një masë/veprimtari ka përfunduar plotësisht, duhet të jepen arsytetime lidhur me ndikimin që ato do të sjellin. P.sh., në qoftë se një masë/veprimtari, e përfunduar, i referohet miratimit të një dokumenti specifik, ligji apo akti nënligjor, struktura përgjegjëse duhet të japë informacion mbi ndikimin që do të sjellë legjislacioni i miratuar. Për të gjitha masat, duhet të jepen në mënyrë periodike të dhëna statistikore për të argumentuar nivelin e zbatimit së treguesve të planifikuar (p.sh. numri i mësuesve të trajnuar, etj.).

9. ANALIZA E REZULTATEVE

9.1. Analiza e nivelit të realizimit të Masave/Veprimtarive

Institucioni i sigurimit të cilësisë (ASCAP-i), analizon dhe vlerëson nivelin e realizimit të masave/veprimtarive, mbi bazën e të dhënave të institucioneve përgjegjëse/kontribuese.

Analiza shoqërohet me faktorët që kanë pasur ndikim në arritjen apo mosarritjen e rezultateve të pritshme në zbatim të masave/veprimtarive, si dhe evidenton strukturat përgjegjëse me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

9.2. Analiza e nivelit të realizimit të produkteve

Ky seksion analizon progresin e arritur në realizimin e produkteve. Analiza do të shoqërohet me vlerësimin, nëse nivelet e synuara të realizimit të produkteve janë arritur apo ka të ngjarë të arrihen. Për të gjitha produktet, raporti duhet të japë të dhëna të qarta dhe të mjaftueshme mbi statusin e tyre. Nëse për disa produkte veprimtaria nuk ka filluar, apo është shtyrë për shkak të problemeve të veçanta që kanë lindur (p.sh. mungesa e fondeve, probleme në bashkëpunimin mes institucioneve etj.), informacioni duhet të paraqitet i arsyetuar.

9.3. Analiza e nivelit të realizimit të objektivave

Ky seksion do të përgatitet në bazë të progresit të arritur në funksion të arritjes së objektivave. Do të jepet një pasqyrë e shkurtër mbi zbatimin e çdo objektivi specifik, të përcaktuar në planin e veprimit. Në këtë seksion do të jepen arritjet/mosarritjet gjatë periudhës së vlerësimit, shoqëruar me faktorët që kanë pasur ndikim në arritjen apo mosarritjen e objektivave. Për dhënien e informacionit të saktë, lidhur me këtë seksion, do të përdoren të dhëna statistikore.

10. PRODUKTET E VLERËSIMIT

Produktet e pritshme janë, si më poshtë:

- Raporti i ndërmjetëm i vlerësimit, me rekomandimet përkatëse.
- Raporti Vjetor i Vlerësimit të Performancës së SAPU-së, me rekomandimet përkatëse.
- Raporti 5-Vjeçar i Vlerësimit të Performancës së SAPU-së, me rekomandimet përkatëse.

KAPITULLI III

1. ANEKS: PASAPORTA E TREGUESVE TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026

Qëllimi i Politikës	Objektivi Strategjik	Lista e Indikatorëve/Treguesve të Strategjisë
A	A1	Përqindja e fëmijëve nga moshë 3-6 vjeç të përfshirë në edukimin në fëmijërinë e hershme.
		Shkalla e pjesëmarrjes të fëmijëve 5-6 vjeç në klasat përgatitore dhe grupet e 3-ta të kopshteve, sipas gjinisë.
		Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 1.
		Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 2.
		Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 3.
		Raporti bruto i regjistrimeve në klasën e pestë.
		Raporti bruto i regjistrimeve në klasën e nëntë.
		Përqindja e fëmijëve të moshës më të madhe për klasën përkatëse - niveli ISCED 1.
		Përqindja e fëmijëve të moshës më të madhe për klasën përkatëse - niveli ISCED 2.
		Numri i nxënësve rezidentë të huaj në Shqipëri, nxënësve emigrantë, nxënësve azilkërkues/refugjatë, nxënësve të huaj pa shtetësi dhe nxënësve shqiptarë pa shtetësi.
	A2	Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin bazë.
		Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë.
		Përqindja e nxënësve romë dhe egjiptianë në arsimin bazë që e përfundojnë atë
		Përqindja e nxënësve romë dhe egjiptianë në arsimin e mesëm të lartë që e përfundojnë atë.
		Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin parauniversitar.
		Fëmijët me aftësi të kufizuara të integruar në shkollat publike jospesiale në raport me totalin e nxënësve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin.
		Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 1
		Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 2
		Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 3
		Numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike.
Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë.		
Numri i nxënësve në klasa kolektive të transferuar në shkollat e afërta me cilësi më të mirë.		

		Numri i shkollave të rinovuara dhe të ndërtuara.
		Numri i oficerëve të sigurisë në shkolla.
A3		Përqindja e programeve të akredituara për formimin fillestar të mësuesve në universitetet publike.
		Përqindja e mësuesve të: arsimit parashkollor që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve (p.sh. trajnim në aspektin pedagogjik) para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës.
		Përqindja e mësuesve të: arsimit fillor që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve (p.sh. trajnim në aspektin pedagogjik) para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës.
		Përqindja e mësuesve të: arsimit të mesëm të ulët që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve (p.sh. trajnim në aspektin pedagogjik) para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës.
		Përqindja e mësuesve të: arsimit të mesëm të lartë që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve (p.sh. trajnim në aspektin pedagogjik) para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës.
		Përqindja e mësuesve që kanë marrë trajnim gjatë punës në 12 muajt e fundit sipas llojit të trajnimit.
		Përqindja e mësuesve që kanë plotësuar në nivel të lartë standardet profesionale të mësuesit dhe kanë avancuar në kategoritë e kualifikimit.
	A4	
		Numri i mësuesve të përfshirë në aktivitete këshillimi dhe monitorimi për zbatimin e kurrikulës së re me kompetenca në të gjithë komponentët e saj.
		Rezultatet e nxënësve 15-vjeçarë në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca.
		Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve në fund të arsimit të mesëm të ulët të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim dhe matematikë, sipas gjinisë.
		Numri i monitorimeve të zhvilluara në shkolla për zbatimin e kurrikulës me kompetenca.
		Përqindja e nxënësve që do të mësojnë zeje dhe arte në arsimin e mesëm të lartë.
A5		Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 1.
		Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 2.
		Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 3.
		Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 1.

		Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 2.
		Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 3.
		Përqindja e shkollave që kanë akses në kompjuter për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 1.
		Përqindja e shkollave që kanë akses në kompjuter për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 2.
		Përqindja e shkollave që kanë akses në kompjuter për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 3.
		Raporti kompjuter-nxënës në shkolla.
		Numri i shkollave me shërbim wireless.
		Numri i shkollave që kanë faqen e tyre në internet, rrjete sociale.
		Shpejtësia e internetit në shkolla.
		Përqindja e shkollave që përdorin platformat online.
B	B1	Përqindja e inspektorëve të trajnuar.
		Numri i të certifikuarve nga Shkolla e Drejtorëve.
		Përqindja e drejtorëve që u është vlerësuar performanca.
		Përqindja e shkollave që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm.
		Numri i vlerësimeve nga ASCAP-i bazuar në risk.
	B2	Publikohen të dhëna për treguesit kombëtarë të arsimit.
		Analiza e performancës së sistemit bëhet në baza vjetore.

2. REFERENCAT

- [1] Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021 - 2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj" ,Tiranë 2021.
- [2] VKM Nr. 98, datë 27.02.2019, "Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ”.
- [3] INSTAT, "Databaza statistikore" [Online].
- [4] OECD, "OECD Reviews of Evaluation and Assessment: Albania", OECD Publishing, Paris, 2020.
- [5] UNESCO, "Albania: education policy review; lissues and recommendations, extended report", Paris, 2017.
- [6] Programme for International Student Assessment (PISA) 2012, 2015, 2018, 2021 etj.
- [7] Pasaporta e Treguesve të Dokumentit Strategjik 2021-2026.
- [8] M. Wort, D. Pupovci and E. Ikonomi, "Vlerësimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020", UNICEF, 2019.

HARTOI METODOLOGJINË:

GRUPI KRYESOR

Gerti Janaqi
Bashkim Muça

GRUPI NDIHMUES

Redian Dengeri
Mirela Kondili
Ermal Kola
Lindita Çifçi
Erjola Shehaj
Etleva Lundra
Adela Iljazi
Albina Nuredini